



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:039597  
Datë: 29.03.2024  
Numri i dokumentit: 05527475

PAKR.nr.92/24

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Xhevdet Abazi anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes Erna Stubla- procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit I. R për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par. 2 nënpar. 2.6 dhe 2.7, lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit I. R, av. Dardan Hakiu, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, 2023:114116 i datës 08.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 27.03.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. ME APROVIMIN e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit I. R, av. Dardan Hakiu, por edhe sipas detyrës zyrtare, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, 2023:114116 i datës 08.12.2023, dhe atë vetëm përkitazi me sanksionin penal – dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit I. R për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par. 2 nënpar. 2.6 dhe 2.7, lidhur me par.1 të KPRK-së, i përcakton dënim burgimi në kohëzgjatje prej tre (3) vite, në të cilën i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 13.02.2023 e tutje, por jo më tepër se dënimi i shqiptuar.

Në pjesët e tjera aktgjykimi mbetet i paprekur.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin 2023:114116 të datës 08.12.2023, të akuzuarin I. R për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par. 2 nënpar. 2.6 dhe 2.7, lidhur me par.1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) viteve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në dënimin e shqiptuar të akuzuarit do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe atë prej datës 13.02.2023, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, por jo më tepër se dënimi i shqiptuar.

Konform nenit 19 pika 1.38.4 dhe 1.39.7 të KPPRK-së, janë konfiskuar në mënyrë të përhershme provat materiale si në urdhëresën për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dhe atë: kapela me ngjyrë të zeza, një palë dorëza ngjyrë portokalli me të zezë, një radio lidhje ngjyrë e zezë me mbishkrim Kydera, një thikë e vogël e zezë- brisk, një bateri dore ngjyrë e zezë me mbishkrim Led Lanser, pallto ngjyrë e zezë, shall ngjyrë teget me mbishkrime ngjyrë portokalli, prova këto të cilat kanë lehtësuar veprimet e të akuzuarit në mbështetje të veprës penale si dhe të hollat: 1x50 euro, me numër serik ..., 1x20 euro, me numër serik ..., 1x10 euro, me numër serik ..., 1x5 euro, me numër serik ..., të gjitha këto të gjetura në trupin e të akuzuarit I. R me rastin e arrestimit.

Konform nenit 113 të KPPRK-së, i janë kthyer të dëmtuarës Xh. H stolitë e arit: dy zingjir dore, dy zingjir qafe, tre palë vathë, një lirë dhe një unazë ari, të cilat janë gjetur në trupin e të akuzuarit I. R me rastin e arrestimit dhe të cilat e dëmtuara i ka identifikuar dhe ka deklaruar se janë të saj.

E dëmtuara Xh. H nga fshati Bibaj, Komuna Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Është obliguar i akuzuari që më emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën njëqind euro (100 €), si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej pesëdhjetë euro (50 €), të gjitha këto në afat pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga data kur aktgjykimin të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi e të akuzuarit I. R, av. Dardan Hakiu, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vendimit mbi sanksionin penal dhe shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovon si të bazuar

ankesën e tij dhe ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar, përkritazi me vendimin mbi sanksionin penal ashtu që ndaj të akuzuarit të shqiptoj një dënim më të butë apo çështjen ta kthej në rivendosje, ndërsa të akuzuarin të e liroj nga masa e paraburgimit.

Prokurori i Prokurorisë së Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.105/2024 të datës 16.02.2024 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankësa e mbrojtësit të akuzuarit I. R, av. Dardan Hakiu, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, 2023:114116 i datës 08.12.2023, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit të Kosovës, mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 paragrafi 1. të KPPK-së në të cilën kanë marrur pjesë i akuzuari I. R dhe mbrojtësi i të akuzuarit I. R, av. Dardan Hakiu. Ndërsa, Prokurori i Apelit, e dëmtuara Xh. H dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar Xh. H Av. Fitim Shabani, nuk prezantuan në seancën e kolegjit, ndonëse të njoftuar në kohë dhe në mënyrë të rregullt. Mbrojtësi i të akuzuarit I. R, av. Dardan Hakiu në seancën e kolegjit ka deklaruar se qënsron pran pretendimeve ankimore të theksuara në ankesë, shkeljet esenciale janë bërë për shkak se Gjykata nuk i ka vlerësuar, e as arsyetuar si duhet rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Ne propozojmë shqiptimin e dënimit më të butë, për shkak se konsiderojmë që në rastin konkret pranimi i fajësisë nuk është vlerësuar mjaftueshëm nga Gjykata e shkallës së parë. I akuzuari I. R deklaroi se e mbështetë avokatin dhe ankesën e dorëzuar në Gjykatë.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore mbrojtësit të akuzuarit I. R, av. Dardan Hakiu, së bashku me shkresat tjera të lëndës, ashtu që pas vlerësimit të njëjtave gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit është e bazuar përkritazi me vendimin mbi sanksionin penal.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit I. R, av. Dardan Hakiu

Mbrojtës i të akuzuarit në pretendon se Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për shkak se ka shkelur nenin 384 par. 2 nënpar. 2.9 pasi që nuk e ka përpiluar aktgjykimin në përputhje me nenin 369 par. 8 i KPPK-së.

Përkatësisht, ka bërë shkelje kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin me 4 vite burgim për veprën penale të vjedhjes së rëndë, duke mos i marrur parasysh rrethanat lehtësuese por vetëm duke i parafrazuar ato. Sipas mbrojtjes, sikur Gjykata të i vlerësonte këto rrethana lehtësuese,

referuar nenit 71 të KPRK-së, e njëjta do të mund të i shqiptonte të akuzuarit një dënim nën kufirin e përcaktuar ligjor për shkak ai ka pranuar fajësinë.

Ndërkaq, lidhur me rrethanat rënduese, mbrojtja konsideron se i ka peshuar në mënyrë subjektive, duke mos i arsyetuar dhe duke mos i analizuar në përputhje me rrjedhën e ngjarjes.

Lidhur me vendimin mbi sanksionin penal mbrojtja pretendon se Gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrur parasysh rrethanat lehtësuese si faktin që i akuzuari ka pranuar fajësinë, nuk ka qenë i ndjekur penalisht as i gjykuar më parë, ka shprehur pendim të thellë për veprën penale, i ka kërkuar falje familjes dhe ka shprehur gatishmëri për të kompensuar dëmin, si dhe faktin që është prind i një vajze dy vjeçare.

Gjithashtu, sipas mbrojtjes me dënimin e shqiptuar nuk arrihet qëllimi i dënimit siç përcaktohet me ligj, e madje shqiptimi i të njëjtit përbën shkelje të qytetarit para ligjit. Kjo sepse mbrojtja pretendon që dënimi i shqiptuar është në kundërshtim me praktikën gjyqësore dhe për të mbështetur këtë argument ka listuar dhe ka bashkangjitur disa aktgjykime të cilat kanë trajtuar veprën e njëjtë penale në rrethana të ngjashme.

Për më tepër, mbrojtja pretendon që me aktgjykimin e ankimuar është bërë shkelje e barazisë së qytetarit para ligjit mbi bazën e diskriminimit referuar nenit 3, 24, 31 dhe 33 të Kushtetutës tonë, për shkak se i dëmtuari është biznesmen i njohur në Ferizaj, ndërsa i akuzuari ka prejardhje nga Bujanoci dhe është shtetas i Serbisë me kombësi shqiptare, si dhe për shkak të mospërputhjes së dënimit të shqiptuar me praktikën gjyqësore.

Sipas mbrojtjes, nxjerra e një aktgjykimi jo të drejtë dhe të paarsyetuar nga Gjykata e shkallës së parë bie ndesh edhe me praktikën e GJEDNJ-së, vendime këto obligative për zbatim nga Gjykatat tona referuar nenin 53 të Kushtetutës tonë.

### Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

#### Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, Kolegji penal konstaton se pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit I. R, av. Dardan Haku, nuk janë të bazuara. Kolegji i Apelit konform nenit 394 par.1 të KPPK-së gjeti se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera e të cilat do të kushtëzonin anulimin e aktgjykimit të ankimuar, sepse

dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, në të nuk ka kundërthënie me vetveten e as me arsyet e tij, është i qartë dhe konkret. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyet e duhura dhe të mjaftueshme mbi të gjitha faktet relevante dhe rrethanat e kësaj çështje penale. Pra, Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

#### Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm,

Kolegji pretendimin për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e trajtoi në kuadër të pretendimeve lidhur me bazën ankimore, përkitazi me vendimin mbi dënim, për shkak se referuar nenit 383 par.1 të KPPRK-së, shkelja e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nuk bënë pjesë në arsyet e përcaktuar me ligj për ushtrimin e ankesës ndaj aktgjykimit

#### Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me vendimin mbi dënimin

Gjykata e Apelit në Prishtinë vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit lidhur me vendimin mbi dënimin janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë parasysh faktin që i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza e ri kualifikuar, ofrimin e tij për pranimin e fajësisë që në seancën e shqyrtimit fillestar për veprën penale të vjedhjes së rëndë (ende pa u bërë rikualifikimi juridik nga vepra penale e grabitjes në veprën penale vjedhje e rëndë), pendimin e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale, si dhe faktin që Gjykata nuk ka të dhëna penale se i akuzuari është gjykuar me vendim të formës së prerë më parë. Ndërkaq, si rrethanë rënduese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale e cila është kryer në orët e vona pas mesnatës natës, duke u futur brenda në shtëpi i maskuar dhe duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm material, si dhe faktin që në shtëpi në kohën e kryerjes së vjedhjes ka qenë e dëmtuara e vetme me 4 vajzat e saj të gjitha të mitura (binjaket disa muajsh) dhe tek e njëjta është shkaktuar ankth, frikë dhe pasiguri e madhe, andaj duke vlerësuar këto rrethana ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimi të ankimuar

Dënimi i shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë me katër (4) vite burgim në rrethanat e çështjes rezulton se është dënim i ashpër, duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë

në shqyrtimin gjyqësorë dhe ofrimin e tij për pranimin e fajësisë që në seancën e shqyrtimit fillestar për veprën penale vjedhje e rëndë (ende pa u bërë rikualifikimi juridik), të cilave rrethana nuk i është dhënë rëndësia e duhur me rastin e caktimit të dënimit, në ndërlidhje edhe me rrethanat e tjera se i njëjti është penduar për kryerjen e veprës penale dhe faktin që Gjykata nuk ka të dhëna penale se i akuzuari është gjykuar me vendim të formës së prerë më parë, paraqesin rrethana të atilla që në unitetin tyre tregojnë se edhe me një dënim më të ulët, të caktuar tani si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mund të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Kolegji vendosi që dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për të akuzuarin I. R është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat e kryerjes, pasojat e shkaktuara si dhe me bindjen se dënimi do të ndikoj në parandalimin e kryerjes së veprave penale në të ardhmen si dhe të ndikoj tek personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 403 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVES

Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.92/24, datë 27.03.2024

Praktikantja gjyqësore

Erna Stublla

Anëtarët e kolegjit

Kadrije Goga Lubishtani

Kryetar i kolegjit

Hashim Çollaku

Xhevdet Abazi